



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DIMAL  
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

NR 49 DATË 09/07/2021

**“MBI MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT TË NDIHMËS SË MENJËHERSHME FINANCIARE PËR FAMILJET NË NEVOJË PËR VITIN 2021 NË MASËN 50.000 (pesëdhjet mijë)LEKË PËR FAMILJEN E ZNJ.VIOLETA JORGJII ÇOBO**

Këshilli i Bashkisë Dimal i mbledhur më datë 09/07/2021 , mbi bazën e materialit të paraqitur dhe relatuar nga Sektori i Ndihmës Ekonomike në Bashkinë Dimal, në mbështetje të Ligjit Nr 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", nenet neni 9, pika 1/1a dhe 1/1b 41, 53 54 dhe 55; mbështetur në kërkesat e nenit 32 të ligjit Nr.9936 datë 26.06.2008 “ Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë ” dhe në vijim, ligjit nr. 68/2017 ”Për financat e veteqeverisjes vendore”; ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të ndryshuar; Ligji 137/2020 "Për buxhetin e vitit 2021", Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të NJQV”; Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit te buxhetit”, Udhëzimi nr. 10 ,date 28.02.2020 “Per përgatitjen e programit buxhetor afatmesem vendor 2021-2023” dhe shtojcat plotësuese; Udhëzimi nr. 27 , date 10.07.2020 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2021-2023, Ligjit Nr. 9355 datë 10.03.2005 “ Për ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore ” i ndryshuar, VKB nr.81, datë 24.12.2020 “Për miratimin e buxhetit afatmesëm 2021-2023” dhe Buxhetin e Detajuar 2021,**konfirmim i bazueshmërisë ligjore nga Institucioni i Prefektit për VKB nr. 81, datë 24.12.2020, shkresa me nr. 1119/3 prot, datë 08.01.2021** Ligji Nr 34/2021 datë 16.03.2021 ”Për Ndryshimin e Emërimit të Njesisë së Qeverisjes Vendore nga “Bashkia Ura Vajgurore” në “Bashkia “Dimal”,Fletore Zyrtare e Republikës së Shqipërisë Numri 55 e Enjte ,8 Prill 2021.Urdhër i Titullarit të Institucionit të Bashkisë “Dimal”Nr 1771 Prot datë 01/06/2021 “Për Hartimin e Dokumentacionit Zyrtar”

## VENDOSI

### Me 14 VOTA PRO nga 14 Këshilltarë prezentë të miratojë:

1. Të miratojë përdorimin e Fondit Ndhmës së Menjëhershme Financiare për familjet në nevojë për vitin 2021 në masën 50.000 ( pesëdhjetë mijë) lekë për familjen e Znj. Violeta Jorgji Çobo
2. Të miratojë përdorimin e Fondit të Ndhmës së Menjëhershme Financiare, në masën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë për familjen e Znj. **Violeta Jorgji Çobo** , familje në gjendje të vështirë ekonomike ku **znj. Violeta Jorgji Çobo është në gjendje shëndetësore të rënduar** me 2(dy) fëmijë ,duke e pasur të vështirë të përballojë jetesen kushtet minimale për rritjen e femijëve të saj të cilët janë në një moshë tepër delikate të procesit të rritjes së tyre dhe pamundësi ekonomike për blerjen e medikamenteve për kurimin e saj.

*Shënim:* Fondi për vitin 2021 në masën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë, do të përballohet nga fondi ndihmë për familjet në nevojë i parashikuar në Buxhetin afatmesëm të Bashkisë Dimal “ Ura Vajgurore” për vitin 2021-2023 dhe Buxhetin e Detajuar 2021

Kryetar i Këshillit Bashkiak



